



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:214406
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05506344

A.C.nr.3306/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj, dhe Besnik Bislímaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Z.Z., me vendbanim në fshatin ... Komuna e Pejës, tani me punë dhe vendqëndrim të përkohshëm në shtetin e Zvicrës, të cilën me autorizim e përfaqëson J.R., avokat me seli në Komuna Prizren, kundër të paditurve V.O.me vendbanim në Rr. "...” nr., Komuna Prizren, dhe Gj.O. me vendbanim në Rr. "...” nr., Komuna Prizren duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga propozuesit e masës së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2045/2021 datë 16.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e propozueses të masës së sigurimit Z.Z., me vendbanim në fshatin ...Komuna e Pejës, tani me punë dhe vendqëndrim të përkohshëm në shtetin e Zvicrës, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2045/2021 datë 16.02.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.2045/2021 datë 16.02.2024, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET kundërshtimi (përgjigja) i paraqitur nga kundërshtari i masës së përkohshme të sigurimit Gj.O. si i bazuar.

II. ANULOHET aktvendimi Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.2045/2021, e datës 24.09.2021, me ëtë cilin është caktuar masa e përkohshme e sigurimit.

III. REFUZHET si i pabazuar propozimi i propozueses së masës së sigurimit Z.Z., me banim në fsha ...Komuna e Pejës, për caktimin e masës së sigurisë dhe që kundërshtarëve të sigurimit V.O dhe Gj.O. nga Prizreni, që të „I ndalohet, tjetërsimi, fshehja, ngarkimi apo ndërmarrja e çfarëdo veprimi i paluajtshmërisë në parcelën lëndore me numër P-71813068-06488-0 ZK Prizren“.

IV. Procedura në këtë çështje kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe planit të punës të Gjykatës...”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ka parashtruar ankesë propozuesja e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar ankesa e propozuesve dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi aktvendimi i datës 24.09.2021.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit/ve 194, dhe nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesja e masës së sigurimit Z.Z., përmes të autorizuarit të saj, me datë 24.09.2021, në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurve - V.O.me vendbanim në Rr. “...” nr., Komuna Prizren, dhe Gj.O. me vendbanim në Rr. “...” nr., Komuna Prizren, me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2045/2021 datë 24.09.2021 e ka caktuar masen e përkohshme të sigurimit.

Të paditurit me datë 13.12.2023 kanë parashtruar përgjigje kundër caktimit të masës së sigurimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 05.02.2024, dëgjimit të palëve në procedurë dhe administrimit të provave, ka marrë aktvendim C.nr.2045/2021 datë 16.02.2024, me të cilin e ka refuzuar propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartpërmendura, vendosi që masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.2045/2021, të datës 24.09.2021 ta anuloj, ngase nga provat e administruara shihet se të paditurit përmes punëve juridike tashmë janë regjistruar si pronar me nga 1/4 të parcelës kontestuese në librat kadastral pranë ZK Prizren, andaj lënia në fuqi e kësaj mase do të ishte e pakuptimtë dhe nuk do të arrihej qëllimi për të cilën caktohet masa e sigurimit. Prandaj mbi këtë bazë gjykata vlerëson se me anulimin e kësaj mase nuk ka ndonjë rrezik real se pala kundërshtarë do të mund t’ia pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së paditëses-propozueses së masës së përkohshme të sigurimit, ngase të paditurit që nga ajo kohë kur janë bërë pronar nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim konkret me qëllim të tjetërsimit, ngarkimit apo ndonjë mënyrë tjetër të parcelës kadastrale të lartcekur...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në nenin 297 par.1, pika a) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore ndër të tjera thuhet se *“...masa e sigurimit mund të caktohet në rast se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive...”*, ndërsa në pikën b) ndër të tjera thuhet se *“... duhet të vërtetohet se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar pala kundërshtarë do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*.

Kushtet ligjore të rregulluara me nenin 297 par.1 pika a) dhe b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, duhet të përmbushen e pastaj të caktohet masa e sigurimit, ndërsa në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimet ankimore janë në tërësi të pa themelta dhe të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaftë i kjashtë dhe i kuptueshëm, dhe se pretendimet ankimore kryesisht janë pretendime që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, lidhur me vendosjen për kërkesëpadinë, dhe të njëjtat nuk kanë ndonjë rëndësi sa i përket vendosjes për propozimin për masën e sigurisë, dhe janë në tërësi të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.3306/2024 datë 26.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi